



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6151 Prot.

Maliq, më 19.11.2021

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, “Funksionimi i këshillit bashkiak”, pika 2, pika 4, 5 neni 56 “Kryetari i këshillit bashkiak” pika 2 gërma “a”, dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq” ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq, do të zhvillohet elektronikisht dhe fizikisht në sallën e këshillit bashkiak, si pasojë e zbatimit të protokolleve të sigurisë mbi COVID-19, ditën e **premtë, më datë 26.11.2021, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.10.2021;
3. Miratimi i raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë Këshillit Bashkiak “Për dhënien e mandatit të këshilltarit për zj. Xhensila Nakoleci”;
4. P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin tetor 2021”;
5. P-V “Për faljen e qirasë sociale për një periudhë 6-mujore për 3 familje të cilat janë strehuar në banesën sociale të ish-Laboratori”;
6. P-V “Për shtesë në limitin e furnizimit me karburant për mjetin borëpastrues me tragë AA 423 PG”;
7. P-V “Për ngritjen e Muzeut Vendor Arkeologjik Maliq”;
8. P-V “Për dhënien e titullit “Mirënjohja e Bashkisë Maliq” z.Koçi Tahiri”;
9. Diskutime të tjera.

Ju faleminderit!

KRYETARI KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

